



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program

## E drejta kushtetuese dhe administrative

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	N-LAWCAL120C
Titulli	Magjistër i shkencave juridike - Drejtimi: E drjeta kushtetuese dhe administrative
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-612/4
Vendimi për fillim me punë	03-1619/18 (10.11.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

## Përshkrimi i programit

Qëllimi i programit studimor e drejta kushtetuese dhe administrative është të ofrohen module të cilët do ta përfshijnë bazën e njohurive kushtetuese-administrative për përafrimin ndaj profesioneve juridike të cilat janë të ndërlidhura me lëmin e të drejtës kushtetuese dhe administrative dhe të sigurohen njohuri solide, të posaçme dhe sistematike për institucionet dhe për bazat e sistemit kushtetues dhe administrativ të Republikës së Maqedonisë si dhe njohuri krahasimtare të rajonit dhe të Bashkimit Evropian nga lëmi përkatës.

## Karriera

Diploma e programit studimor do t'u mundësojë studentëve të studimeve të magjistraturës të aftësohen për t'i zbatuar njohuritë dhe shkathtësitë e përgjithshme dhe të posaçme teorike dhe praktike profesionale dhe kushtetuese-administrative në praktikë; të ofrojnë përgjigje analitike si nga pikëpamja e zbatimit të akteve normative juridike, ashtu edhe nga pikëpamja e ndryshimit të rregullativës juridike; t'i shqyrtojnë dhe t'i hulumtojnë fenomenet dhe problemet kushtetuese-administrative dhe të japin propozime kreative për zgjidhjen e tyre; në mënyrë kritike dhe argumentative t'i analizojnë dhe t'i evalulojnë zgjidhjet juridike dhe funksionimin e institucioneve juridike-kushtetuese-administrative në praktikë; të vijojnë me perfeksionimin e mëtejshëm të studimeve të doktoratës në lëminë e shkencave juridike- kushtetuese-administrative; ta ndjekin zhvillimin e legjisllacionit dhe të praktikës juridike dhe të angazhohet për zbatimin e rezultateve shkencore të hulumtimit në praktikën legjisllative dhe juridike.

## Rezultatet e të mësuarit

### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Tregon njohuri dhe kuptim për të drejtën kushtetuese dhe të drejtën administrative, duke zbatuar metodologjinë adekuate për zgjidhjen e problemeve komplekse kushtetuese dhe administrative, si në mënyrë sistematike, ashtu edhe në mënyrë kreative, që siguron bazë, apo mundësi për origjinalitet në zhvillimin dhe/ose zbatimin e ideve autonome në kontekst të

hulumtimit kushtetues e administrativ;

- Aftësi për përdorimin e dijeve të gjera dhe të thella kushtetuese-administrative;
- Tregon nivel të lartë të kompetencës në të drejtën kushtetuese-administrative;
- Posedon dije nga njëra ose më shumë lëndë të lëmisë, të cilat, në fushat e dhëna shkencore, mbështeten në hulumtimet më me renome ndërkombëtare në lëminë kushtetuese-administrative.

### **Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

- Aftësi për zgjidhjen kritike, të pavarur dhe kreative të problemeve me origjinalitet të caktuar në mjedise të reja ose të panjohura dhe në kontekst multidisiplinar, të ndërlidhur me trendet bashkëkohore të së drejtës kushtetuese dhe administrative.

### **Aftësitë për të vlerësuar**

- Aftësi për sintetizimin dhe integrimin e dijeve;
- Aftësi për menaxhimin me çështje komplekse, sistematikisht dhe kreativisht, për vlerësimin solid, madje edhe gjatë informacioneve jo të plota dhe të kufizuara, por të cilët i përfshijnë përgjegjësitë personale, shoqërore dhe etike gjatë zbatimit të dijeve të fituara kushtetuese dhe administrative;
- Aftësi për vlerësimin dhe seleksionimin e teorive shkencore, metodologjive, mjeteve dhe shkathtësive të përgjithshme nga lëmitë e lëndëve dhe vendosja e analizave dhe zgjidhjeve të reja në baza shkencore.

### **Aftësitë e komunikimit**

- Aftësi për këmbimin e konkluzioneve dhe propozimeve me mbështetjen me argumente dhe me mbështetje racionale të tyre, si me persona profesionistë, ashtu edhe me persona joprofesionistë, qartë dhe bindshëm;
- Marrja e përgjegjësisë së konsiderueshme për rezultatet e përbashkëta; menaxhimi dhe iniciimi i aktiviteteve.

### **Aftësitë e të mësuarit**

- Aftësi për njohjen e nevojës personale për dijet e mëtejshme dhe aftësi për veprimin e pavarur dhe të mëvetësishëm gjatë fitimit të dijeve dhe shkathtësive të reja në kontekst nacional, rajonal dhe evropian si dhe në kontekst botëror;
- Aftësi për marrjen e përgjegjësisë për zhvillimin dhe perfeksionimin e mëtejshëm profesional.

## **Lista e lëndëve**

### **Semestri 1**

- [MCAL-0101] [6.0 SETK] **E drejta kushtetuese e zbatuar**
- [MCAL-0102] [6.0 SETK] **E drejta administrative e zbatuar**
- [MCAL-0103] [6.0 SETK] **Sistemet politike bashkëkohore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### **Semestri 2**

- [MCAL-0201] [6.0 SETK] **E drejta e procedurës administrative**
- [MCAL-0202] [6.0 SETK] **Gjyqësori administrativ**
- [MCAL-0203] [6.0 SETK] **E drejta parlamentare**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### **Semestri 3**

- [MCCR1120] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [EMCA0020] [6.0 SETK] **E drejta kushtetuese e krahasuar**
- [MCAL-0302] [6.0 SETK] **Gjyqësori kushtetues**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## Semestri 4

- [MCCAL4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **E drejta kushtetuese e zbatuar**

Qëllimet e programit të lëndës: Fitimi i njohurive për konceptet, dukuritë dhe institutet e të drejtës kushtetuese dhe të institucioneve shtetërore në Maqedoni, përfshirë edhe qëndrimet e ndryshme teorike për to. Fitimi i njohurive konkrete për të drejtën kushtetuese si shkencë dhe degë juridike, duke përfshirë analizën krahasimtare të gjendjes dhe perspektivat e saj në domenin rajonal dhe evropian. Nëpërmjet këtij moduli, studentët do të fitojnë njohuri themelore teorike dhe praktike në lidhje me organizimin e organeve shtetërore dhe të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit; Inkurajimi i mendimit kritik te studentët për çështjet themelore të rregullimit kushtetues të Republikës së Maqedonisë dhe në suaza të BE-së, me çrast, do të mbahet llogari për profilin e juristit evropian i cili, në të ardhmen, si një ekspert do të duhet ta interpretojë dhe ta zbatojë të drejtën kushtetuese në rrafshin nacional dhe evropian; Planprogrami do të trajtojë materien kushtetuese në aspektin krahasimtar dhe nacional, sepse në kushtet e globalizimit, e drejta kushtetuese nuk mund të kuptohet nëse konsiderohet vetëm në aspektin nacional; Planprogrami, gjithashtu, në vetvete do të mbulojë: Rregulloren e re të punës së Kuvendit e cila ka një rol kyç në zhvillimin e demokracisë parlamentare në Maqedoni, ligjet e reja që rregullojnë materien kushtetuese, siç janë: ligjet që kanë të bëjnë me gjyqësorin, pushtetin vendor, sistemi zgjedhor, shoqëria civile, mbrojtjes, politikës së jashtme, etj; Përveç kësaj komponente normative, planprogrami do të përpunojë dhe praktikën e organeve qendrore të pushtetit shtetëror në RM, përkatësisht të: Kuvendit, Qeverisë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Supreme, e cila ka një ndikim të fortë në të drejtën kushtetuese si shkencë; Gjithashtu, do të përfshihen edhe amendamentet kushtetuese të vitit 2001 që kanë një ndikim të madh në demokracinë mazhoritare në RM si dhe në vlerat themelore kushtetuese të rendit kushtetues të RM-së si dhe amendamentet kushtetuese të vitit 2005 lidhur me reformat gjyqësore në RM; Në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të bëjnë dallimet themelore dhe thelbësore midis institucioneve kushtetuese, ndërlidhjen e tyre dhe funksionimin e tyre praktik; T'i bëjnë dallimet e nevojshme teorike dhe praktike mbi konceptet, dukuritë dhe institutet e të drejtës kushtetuese; T'i përkrahajnë dhe analizojnë proceset e ndryshme brenda sistemit dhe rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë në të gjitha aspektet e jetës kushtetuese të vendit, do të thotë të njeriut, qytetarit, shtetit dhe komuniteteve etnike.

- **E drejta administrative e zbatuar**

Qëllimet e lëndës: - I definojnë dhe i kuptojnë konceptet e administratës dhe funksioneve administrative; - E njohin dhe e analizojnë legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike në Maqedoni; - T'i shqyrtojnë veprimtaritë kryesore të funksionit administrativ; - Të bëjnë dallimin në mes të llojeve të akteve të administratës dhe të zotërojnë hapat e parë të krijimit të akteve të tilla; - T'i mësojnë llojet e mbikëqyrjes administrative; - T'i mësojnë mekanizmat e kontrollit mbi administratën dhe përgjegjësinë e saj para organeve të tjera shtetërore, por edhe para klientëve-përdoruesit e shërbimeve të saj; - Për punësim në të ardhmen në organet e administratës së Republikës së Maqedonisë, OJQ, në institute dhe institucione që merren me zgjidhjen e lëndëve të natyrës juridike administrative.

- **Sistemet politike bashkëkohore**

Lënda ka për qëllim furnizimin e studentëve me njohuri rreth politikave më të zhvilluara në periudhën e sotme, nënkuptohet duke mos i lënë mënjanë edhe vendet të cilat e rrethojnë RM-në si dhe sistemet politike të vendeve më pak të zhvilluara në të gjithë botën. Në përmbajtjen e të gjithë lëndës bëhen paralele dhe analiza krahasimtare në mes të funksionimit të institucioneve të sistemeve politike në vendet të cilat mësohet, si në mes vetes ashtu edhe në rastin e sistemit politik në Rrepublicën e Maqedonisë, në drejtim të gjetjes së praktikave të mira me të cilat do të avancohej ky sistem në Republikën e Maqedonisë.

- **E drejta e procedurës administrative**

Qëllimi i lëndës është aftësimi i studentëve: - T'i përkufizojnë dhe t'i kuptojnë nocionet e administratës dhe funksionit administrativ; - Ta njohin dhe ta analizojnë rregullativën juridike me të cilën rregullohet organizimi dhe funksionimi i administratës publike në RM; - T'i shqyrtojnë veprimtaritë themelore të funksionit administrativ; - Ta bëjnë ndarjen midis llojeve të akteve të administratës dhe t'i zotërojnë hapat e para në krijimin e akteve të këtylla; - T'i mësojnë llojet e mbikëqyrjeve administrative; - T'i njohin mekanizmat e kontrollit mbi punën e administratës dhe përgjegjësinë e saj përpara organeve të tjera shtetërore, por edhe përpara klientëve – shfrytëzuesve të tyre të shërbimeve të saj; - Të

fitojnë aftësi për punësimin e ardhshëm në organet e administratës së RM, organizatat joqeveritare, si dhe të gjitha institucionet në të cilat vendosen çështje të natyrës juridike-administrative.

- **Gjyqësori administrativ**

Qëllimet e lëndës janë: - Përdorimi i drejtë (leximi dhe interpretimi) i normave ligjore me të cilat rregullohet iniciimi, ecuria dhe përfundimi i procedurës gjyqësore-administrative përpara gjykatës administrative dhe Gjykatës Supreme; - Përgatitja e padive për iniciimin e procedurës gjyqësore-administrative (për të gjitha profilet e juristëve); - Ndërmarrja e veprimeve procedurale gjatë procedurës gjyqësore-administrative (për avokat, nëpunës shtetëror që vendosin lëndë administrative, juristë të punësuar në trupa punues dhe në organe të mëvetesishme shtetërore, gjyqtar të Gjykatës administrative, si dhe për shërbimet profesionale në Gjykatën administrative); - Përpunimi i vendimeve (aktvendimeve dhe aktgjykimeve) të marra në procedurën administrative të shkallës së parë dhe shkallës së dytë (për gjyqtar të Gjykatës administrative); - Përpunimi i ankimeve dhe padive për ripërtërirjen e procedurës gjyqësore (për avokat, nëpunës shtetëror që vendosin lëndë administrative).

- **E drejta parlamentare**

Qëllimi i kësaj lënde është përvetësimi i njohurive juridike-teorike dhe praktike e të zbatueshme për parlamentin si një organ përfaqësues, legjislativ dhe sovran në suaza të pushtetit shtetëror të shtetit të caktuar, duke përfshirë edhe organizimin e tij, strukturën dhe kompetencat në RM, të shoqëruar edhe me aspektet juridike-krahasimtare.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Studentët do të jenë në gjendje: - T'i aplikojnë metodat kryesore juridike dhe metodat tjera hulumtuese. - Të mbledhin në mënyrë kritike dhe krijuese material kërkimorë, që është relevant dhe që citohet nga autorët në mënyrë selective në përgjigjet e tyre. - Ta kuptojnë vëllimin e procesit të hulumtimit dhe qasjen në metoda të ndryshme të kërkimit shkencor dhe të jenë në gjendje ato t'i kritikojnë. - Ta studiojnë përmes qasjes së avancuar raportin midis teorisë juridike dhe praktikës kërkimore. - T'i aplikojnë shkathtësitë dhe njohuritë e mësuara në tezat e tyre.

- **E drejta kushtetuese e krahasuar**

E drejta kushtetuese krahasimtare i studion aspektet krahasimtare të sistemeve kushtetuese të BE dhe me gjerë, me qëllim të sigurimit të njohurive më të thelluara për parimet dhe për funksionimin e institucioneve kyçe të pushtetit shtetëror në aspektin krahasimtar.

- **Gjyqësori kushtetues**

Qëllimi i lëndës është fitimi i njohurive në lidhje me paraqitjen, zhvillimin dhe format e kontrollit gjyqësor kushtetues të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, për gjyqësinë kushtetuese, me theks në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë dhe të praktikës së saj.

- **Punimi i magjistraturës**

Kjo lëndë u mundëson studentëve t'i bartin shkathtësitë dhe dituritë e tyre për hulumtimin dhe hartimin e detyrës më të komplikuar - shkrimit të punimit të magjistraturës. Lënda është paraparë që tërësisht të jetë praktike dhe studentët t'i fitojnë dituritë dhe aftësitë, shkathtësitë dhe besimin e nevojshëm që t'i qasen hulumtimit dhe shkrimit të tezës. Lënda ka vetëm një rezultat kthyes – t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë tezën e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me efektivitet maksimal. Gjithçka që është paraparë të bëhet ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe të stilit të shkrimit të tezës së magjistraturës duke pasur kujdes me këtë rast për ndalimin e shërbimit me mjetet e palejueshme siç janë: plagjiatura dhe shkelja e të drejtave të autorit, që ndalohen me Statutin e UEJL-së.

## Lëndë zgjedhore

- **E drejta e vetadministrimit lokal**

Lënda ofron informacione dhe njohuri të reja për realizimin e menaxhimit në vetadministrimin vendor. Përmes kësaj lënde studentët: - do të fitojnë njohuri specifike të koncepteve organizative dhe funksionale të vetadministrimit vendor; - do të fitojnë njohuri në lidhje me funksionimin e vetadministrimit vendor, ndarjen e pushtetit dhe raportet midis vetadministrimit vendor dhe pushtetit qendror; - do të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme menaxhimit të mirë duke përdorur modelet dhe qasjet e teorisë moderne të menaxhimit; - do të jenë në gjendje t'i kuptojnë më mirë çështjet që lidhen me funksionimin e vetadministrimit vendor, dhe ata do të jenë në gjendje t'i zgjidhin këto probleme dhe të zbatojnë në mënyrë efikase vendimet e nxjerra; - do të zhvillohen aftësitë organizative dhe drejtuese të tyre për të punuar në administratën vendore;

- **Teoria dhe praktika e federalizmit**

Kjo lëndë studentëve u ofron njohuri për organizimin e shteteve federative, organeve të tyre, kompetencave, llojeve të shteteve të përbëra, disa federata me karakteristike në botë, si dhe për çështjet qendore teorike e praktike të ndërlidhura me shtetet federative, siç janë: Kushtetuta e shtetit federativ, struktura e federatës, ndarja e kompetencave midis federatës dhe subjekteve të saj, pjesëmarrja e subjekteve të federatës në ushtrimin e pushtetit federativ, e drejta e vetorganizimit e subjekteve të federatës, çështja e sovranitetit (shtetshmërisë) në shtetin federativ, perspektivat e federalizmit në botë, si dhe çështja për pozitën e njëjësive federale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Studenti fiton njohuri për nocionet themelore dhe ligjshmëritë e federalizmit, që do ta aftësojnë atë për arsyetimin historik, komparativ dhe kritik të federatave aktuale dhe proceseve lidhur me to.

- **Filozofia e së drejtës**

Përmes studimit të lëndës filozofia së drejtës studentët: - Do të kenë njohuri solide për raportin e filozofisë së të drejtës me disiplinat tjera juridike dhe shkencat shoqërore. - Do të kenë njohuri të domosdoshme për analizën kritike të qasjeve ndaj së drejtës dhe për identifikimin e problemeve filozofike të cilat dalin nga analiza e dispozitave juridike. - Do të jenë në gjendje t'i përshkruajnë llojet e koncepteve lidhur me problemet si vlefshmëria e së drejtës, statusi ontologjik i së drejtës, raporti mes së drejtës dhe sistemeve të tjera normative (moralit, religjioni, etj.) në zhvillimin e tyre historik.

- **Partitë politike dhe sistemet zgjedhore**

Partitë politike janë subjekt themelor i jetës demokratike në çdo shoqëri bashkëkohore. Sistemet zgjedhore janë komponent më i rëndësishëm i çdo sistemi politik, kështu që kjo lëndë ka rëndësi të veçantë për të fituar njohuri të cilat studentëve do t'u mundësojë të pajisen me informacione të duhura për funksionimin e shoqërisë pluraliste. Nëpërmjet të kësaj lënde studentët do të informohen më për së afërmi me thelbin e partive politike dhe me ndikimin e tyre në sistemet politike bashkëkohore, me marrëdhëniet në mes të partive politike dhe demokracisë bashkëkohore si dhe për shumë faktorë të tjerë të cilët e përcaktojnë jetën shoqëro-politike bashkëkohore.

- **Etika dhe administrata publike**

Qëllimet e lëndës: - Njohja e studentëve me konceptet dhe qëndrimet themelore të etikës në sektorin publik dhe administrata e mirë, si koncept kryesor interdisiplinar, në veçanti në lidhje me menaxhimin e mirë publik dhe mbrojtjen juridike të të drejtave procedurale. - Fitimi i dijeve për sjelljen etike të nëpunësve shtetërorë si individë dhe administrata publike si organizatë.

- **Menaxhimi i politikave publike**

Vlerësimi i politikave publike u shfaq në SHBA përpara Britanisë së Madhe, Skandinavisë. Në demokracitë e tjera perëndimore paraqitet disa vite më vonë. Me iniciativën e Bashkimit Evropian janë vendosur rregulla sistematike për financimin e politikave publike të shteteve anëtare. Është e lidhur fortë me racionalizimin e veprimit publik, evaluimin e politikave publike, ka për qëllim ta përcaktojë shkallën në të cilën politika publike ka arritur qëllimet dhe i jep ndikimet e pritshme të publikut. Vlerësimi i politikave publike në përgjithësi përbëhet nga analiza e rezultateve të ndërhyrjes publike, për të ditur nëse ata janë për të arritur objektivat. Në një kuptim më të gjerë, vlerësimi synon të ndërtojë një pozicion në vlerën e ndërhyrjeve publike në bazë të "rezultateve të tyre, ndikimin e tyre që dëshiron të arrihet" dhe duke u mbështetur në të dhënat empirike të mbledhura dhe të analizuara posaçërisht për këtë qëllim.

- **Kontratave administrative**

Qëllimi i lëndës është fitimi i njohurive në lidhje me paraqitjen, zhvillimin dhe format e kontratave administrative, si kontrata specifike publike në rrafshin teorik, praktik dhe krahasimtar.

- **Sistemi i nëpunësve**

Qëllimi i lëndës është aftësimi i studentëve për punë në administratën publike nëpërmjet njohjes me parimet teorike në mbështetje të të cilave është themeluar sistemi i nëpunësve në Republikën e Maqedonisë dhe, para së gjithash, nëpërmjet qëndrimit praktik të studentëve në organet relevante shtetërore (për nëpunësit publikë). Gjithashtu, njohja e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë të nëpunësit shtetëror në Republikën e Maqedonisë (për nëpunësit shtetërorë, avokatët, gjyqtarët e Gjykatës administrative).

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari l përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termet: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuar nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxënies si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të

filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.